



SHOQATA E PRODHUESVE
TË QUMËSHITIT TË KOSOVËS
KOSOVO ASSOCIATION OF
MILK PRODUCERS KAMP

Terms of Reference (ToR)

Angazhimi i studenteve për shërbimdhënie në Konferencën e III-të të Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit të Kosovës

Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (ShPQK) fton studentet e interesuara të angazhohen si asistente teknike në Konferencën e III-të për Biosigurinë, Ndryshimet Klimatike dhe Perspektivat e Zhvillimit në Prodhimin e Qumështit, e cila do të mbahet më **17 dhjetor 2025**, në Prishtinë.

Konferenca organizohet në kuadër të projektit: “Fuqizimi i sektorit të qumështit në Kosovë: Produktiviteti, Cilësia e Qumështit dhe Qëndrueshmëria Klimatike (Faza II)”, i mbështetur financiarisht nga We Effect, Suedia.

1. Angazhimi i studenteve

Angazhimi synon të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe efikase gjatë organizimit dhe zhvillimit të konferencës, duke kontribuar në funksionimin e pandërprerë të aktiviteteve përmes:

- Mbështetjes logjistike,
- Koordinimit të proceseve organizative,
- Asistencës komunikative me pjesëmarrësit,
- Bashkëpunimit të vazhdueshëm me stafin organizues gjatë gjithë ngjarjes.

2. Detyrat kryesore

Studentet e angazhuara do të jenë përgjegjëse për:

- Ndihmë në përgatitjet paraprake për mbarëvajtjen dhe sigurinë e konferencës;
- Asistim në procesin e regjistrimit dhe mirëpritjes së pjesëmarrësve;
- Mbështetje logjistike gjatë konferencës, përfshirë shpërndarjen e materialeve dhe komunikimin me stafin organizues;
- Orientimin dhe informimin e pjesëmarrësve për çështje praktike;
- Kryerjen e detyrave shtesë sipas kërkesës së organizatorëve;
- Pjesëmarrjen dhe kontributin në punëtorinë e Platformës Rajonale që zhvillohet si pjesë e programit të konferencës.



SHOQATA E PRODHUESVE
TË QUMËSHITIT TË KOSOVËS
KOSOVO ASSOCIATION OF
MILK PRODUCERS KAMP

3. Kohëzgjatja e angazhimit

Periodha e angazhimit mbulon përgatitjet dhe realizimin e aktiviteteve të konferencës dhe parashihet të zgjasë nga:

16 dhjetor 2025 – 17 dhjetor 2025,

duke përfshirë përgatitjet, ditën e konferencës dhe mbylljen e aktivitetit.

4. Kriteret e vlerësimit të stafit mbështetës

Vlerësimi i aplikanteve do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze shkruar;
- Të jenë të regjistruar në studime Bachelor ose Master;
- Të demonstrojnë aftësi të avancuara komunikimi dhe bashkëpunimi;
- Përvoja e mëparshme në praktikë profesionale ose pjesëmarrja në konferenca/ngjarje akademike konsiderohet avantazh;
- Të kenë aftësi të qëndrueshme organizative dhe vëmendje ndaj detajeve;
- Të jenë fleksibël, të aftë të punojnë nën presion dhe në ambiente pune të përbashkëta;
- Të tregojnë sjellje të mirë profesionale, etikë të lartë dhe motivim për të dhënë kontribut.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen

- CV e përditësuar;
- Letër motivuese;

6. Afati dhe mënyra e aplikimit

- **Afati i fundit për aplikim:** 10 dhjetor 2025, ora **16:00**.
- Dokumentet duhet të dërgohen me e-mail në adresën: **info@shpqq.org**